

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1104 Prot.


Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 110, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 48, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike* të konstatuara gjatë punimeve për sheshin e grumbullimit të tubave APY03, në fshatin Qafë të Çorovodës, në kuadër të *projektit të Gazsjellësit TAP*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe *Konceptin e Gërmimit të shpëtimit*, në zonën ku janë zbuluar këto gjetje, të paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,


VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë punimeve për sheshin e grumbullimit të tubave APY03, në fshatin Qafë të Çorovodës, në kuadër të projektit të Gazsjellësit TAP, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Konceptin e Gërmimit të shpëtimit, në zonën ku janë zbuluar këto gjetje, të paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të realizohet nga shoqëri e licencuar në arkeologji, gërmimi i hapur arkeologjik i shpëtimit, për sipërfaqen ku janë konstatuar gjetjet arkeologjike, në sheshin e grumbullimit të tubave APY03, fshati Qafë-Çorovodë.
3. Investitori "*TAP AG*" për kryerjen e gërmimit arkeologjik sipas konceptit të sipërcituar, duhet të lidhë më parë Akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të Akt-marrëveshjes tre palëshe.



5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

